

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE PËR SIGURI DHE SHËNDET

Prishtinë, 2021

I. Dispozita e përgjithshme

Qëllimi:

Neni 1.

- Qëllimi ynë në këtë rregullore, është që të rregullojm zbatimin e politikave të nevojshme dhe veprimeve të kërkuara për ti mbrojtur të gjithë pjesëmarrësit gjatë organizimit të garave të karatesë:
- 1. për t'iu siguruar atyre mjedisin më të sigurt sportiv:
 - pa sjellje të keqe fizike,
 - psikologjike
 - seksuale.
- 2. duke i'u afruar atyre respektin maksimal për sigurinë:
 - mirëqenien
 - dinjitetin e tyre.

Neni 2.

- Gjithkush ka të drejtë të gëzojë pjesëmarrjen në ngjarje sportive, të planifikuara dhe të siguruara nga ata që i japin përparësi, mbi të gjitha, sigurisë dhe mirëqenies së të gjithë pjesëmarrësve.

Metoda e zbatimit:

Neni 3.

Prandaj, ka tre dimensionet kryesore të mbrojtjes për t'u zbatuar:

- Sigurimi i një mekanizmi mbrojtës për të lejuar praktikimin e lirë dhe të sigurt të Karatesë, pa pasur frikë nga shkelja e të drejtave personale;
- Mbrojtja e atletëve nga ngacimet dhe abuzimet nga trajnerët, atletët bashkëmoshatarë, miqtë, trajnerët, mjekët, familjet dhe anëtarët e tjerë të rrethit;
- Mbrojtja e trajnerëve, atletëve kolegë, miqve, trajnerëve, mjekëve, familjeve dhe anëtarëve të tjerë të rrethimit nga akuzat e rreme.
- Nënshkrimi i kodit të sjelljes nga të gjithë pjesëmarrësit.

Sjellja dhe përgjegjësia e garuesve

Neni 4.

Në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i politikave të sigurisë dhe shëndetit garuesit duhet:

- Të njohin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin dhe raportimin e dhunës jo-aksidentale;
- Të mbështesin kolegët e tyre dhe inkurajojnë ata të flasin nëse dëshmojnë ose përjetojnë dhunë jo-aksidentale;
- Të rrespektojnë të drejtat, dinjitetin dhe vlerën e të gjithë pjesëmarrësve, pavarësisht nga aftësia e tyre, gjinia dhe prejardhja kulturore;
- Të kontrollojnë durimin e tyre;
- Të përmbahen nga dhënia e vërejtjeve nënçmuese për njerëzit e tjerë;
- Të përmbahen nga bërja e shakave raciste ose seksiste;
- Të përmbahen nga bërja e komenteve të padëshiruara seksuale që ofendojnë, frikësojnë ose poshtërojnë;
- Të shmangin sjelljen intime dhe joprofesionale me trajnerin e tyre;
- Të raportojnë të gjitha rastet e ngacmimeve për të cilat ata janë viktimë ose dëshmitarë;
- Të raportojnë çdo shkelje të dyshuar të kësaj natyre.

Sjellja dhe përgjegjësia e trajnerëve, referëve dhe zyrtarëve të FKK-së

Neni 5.

Në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i politikave të sigurisë dhe shëndetit në FKK:

- Trajnerët, instruktorët, referët dhe zyrtarët e FKK-së duhet të rrespektojnë dinjitetin e garuesve në mënyrë që të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë pavarësisht nga mosha, gjinia, origjina shoqërore dhe etnike, botëkuptimi, feja, bindja politike ose pozicioni ekonomik.
- Trajnerët, instruktorët, referët dhe zyrtarët e FKK-së duhet të përpiqen të pajtojnë kërkesat e sportit në trajnim dhe konkurrencë me streset e mjedisit shoqëror, në veçanti të familjes, shkollës, trajnimit dhe punës,
- Trajnerët, instruktorët, referët dhe zyrtarët e FKK-së duhet të përpiqen të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe pedagogjike,
- Duhet të mos shikojnë, flasin ose kontaktojnë me garues në atë mënyrë, e cila është e padëshirueshme, ndërhyrëse, abuzive, diskriminuese ose e papërshtatshme;
- Të shmangin të gjitha llojet e intimitetit verbal që mund të perceptohet si ngacmim seksual;
- Të shmangin shprehjet, shakatë dhe mendimet që lidhen me gjininë ose orientimin seksual të garuesve në mënyrë negative;

- T'ja bëjnë të qartë anëtarëve të ekipit se çdo diskriminim i paligjshëm bazuar në moshën, seksin, racën, besimin fetar, dëmtimin fizik ose intelektual nuk do të tolerohet;
- Të shmangin kontaktin me garuesit në hapësira private nëse nuk janë të pranishëm disa persona, ose në marrëveshje me prindërit / kujdestarët;
- Të tregojn rrespekt për jetën private dhe dinjitetin e garuesve dhe anëtarëve të shoqërimit;
- Të jenë të drejtë, të vëmendshëm dhe të ndershëm në të gjitha marrëdhëniet me të tjerët;
- Gjithmonë veprojnë në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të tillë që të sigurojnë marrëdhënie të mira brenda dhe në mes të ekipeve;
- Ata duhet të kalojnë informacionin në dispozicion të garuesve për t'u mbikëqyrur për të zhvilluar dhe optimizuar performancën e tyre.
- Në rastin e të miturve, ju gjithmonë merrni parasysh interesat e kujdestarëve ligjorë.
- Të përpiqen për zgjidhje të hapura, të drejta dhe njerëzore për të gjitha konfliktet.
- Trajnerët nuk përdorin ndonjë dhunë ndaj garuesve që ju janë besuar, veçanërisht asnjë dhunë seksuale.
- Trajnerët i edukojnë garuesit të jenë të përgjegjshëm dhe të pavarur, gjithashtu në lidhje me jetën e tyre të mëvonshme ndaj të gjithë njerëzve të tjerë të përfshirë në sporte konkurruese dhe të merren me përgjegjësi me natyrën dhe komunitetin.
- Interesat e sportistëve, shëndeti dhe mirëqenia e tyre kanë përparësi mbi interesat dhe qëllimet e suksesit të trajnerëve, instruktorëve dhe organizatës së tyre sportive.
- Të gjitha masat stërvitore duhet të korrespondojnë me moshën, përvojën, si dhe gjendjen aktuale fizike dhe psikologjike të garuesve.
- Trajnerët duhet të marrin përsipër, me sa kanë njohuri dhe besim, për të parandaluar përdorimin e substancave të ndaluara (doping) dhe për të parandaluar rreziqet e varësisë (abuzimin me drogën, nikotinën dhe alkoolin).
- Të mos ofrojnë asnjë formë shpërblimi tek garuesit me qëllim të shërbimeve seksuale në këmbim;
- Të marrin masa dhe raportojn çdo shkelje të kësaj natyre.

Kodi i nderit për trajnerët:

Neni 7.

Me këtë premtoj (emri & mbiemri, klubi, pozita)

.....

- Unë do të respektoj personalitetin e çdo fëmije, adoleshenti dhe të riu dhe do të mbështes zhvillimin e tyre,
- Unë do të kontrolloj ndjenjat individuale të afërsisë dhe distancës, në sferën intime dhe kufijtë personalë të turpit të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve që më janë besuar ti ushtroj,
- Unë do t'i udhëzoj fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit në vetë-realizimin e tyre për sjelljen e duhur shoqërore ndaj njerëzve të tjerë.
- Unë dua që ata të sillen në mënyrë të drejtë dhe me respekt brenda dhe jashtë botës sportive.
- Unë do të Inkurajoj ata për sjelljen me njerëzit dhe kafshët dhe udhëzoj ata që të merren me përgjegjësi me natyrën dhe komunitetin.
- Unë do të respektoj të drejtën e fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve që më janë besuar mua dhe anëtarëve të tjerë të shoqatës për integritet fizik duke u betuar që të mos ushtroj asnjë formë dhune, qoftë fizike, psikologjike apo seksuale.
- Unë do të siguroj që të rrespektohen sa më mirë dhe besim, rregullat e sportit në veçanti në luftën kundër dopingut dhe abuzimit me drogën si dhe kundër çdo lloj manipulimi të performancës.
- Unë u ofroj fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve, të cilët më janë besuar, liri të mjaftueshme të vetëvendosjes dhe pjesëmarrjes në të gjitha aktivitetet sportive.
- Unë respektoj dinjitetin e çdo fëmije, adoleshenti dhe të rrituri si dhe anëtarëve të tjerë të klubit dhe premtoj që të gjithë garuesit, pavarësisht nga origjina e tyre sociale, etnike dhe kulturore, botëkuptimi, feja, bindja politike, orientimi seksual, mosha apo gjinia, do të trajtohen të barabartë.
- Unë dua të jem një model për fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit që më janë besuar, duke përcjellë gjithmonë pajtueshmërinë me rregullat sportive dhe duke vepruar sipas praktikave të garimit të ndershëm.
- Unë do të marr përsipër të ndërhyj nëse ky kod etik është shkelur në mjedisin tim, dhe në rast të ndonjë "konflikti", unë do të raportoj të gjithë ata që janë përgjegjës në nivelin e menaxhimit, sepse mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve është e para.
- Unë premtoj që marrëdhëniet e mia me garuesit e rritur do të bazohen gjithashtu në vlerat e këtij kodi nderi.
- Me firmën time marr përsipër t'i përmbahem këtij kodi nderi!

Vendi, data, nënshkrimi

Ruajtja e shëndetit dhe sigurisë në gara:

Neni 6.

Në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i politikave së sigurisë dhe shëndetit në FKK, organizatorët e garave duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të sigurojë objektin, që do të ketë hapësirat përkatëse të sigurisë për gara, me tribuna të ndara nga hapësira garuese, me të paktën 1000 vende për shikues dhe kushtet e nevojshme të sigurisë dhe kushtet sanitare-higjienike për gara;
- Të sigurojë mbajtjen e rendit dhe të ndërmarrë masa parandaluese me praninë e obligueshme të policisë apo të sigurimit privat gjatë tërë kohës së garës, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i papenguar i saj;
- Të sigurojë numër të mjaftueshëm të personave zyrtar që do të përkujdesen për mirë vajtjen e garave.
- Të sigurojë mbrojtjen e domosdoshme profesionale shëndetësore të garuesve në garë nëpërmjet mjekut kujdestar, i cili duhet të ketë pajisjet mobile dhe barnatoren mobile gjatë tërë kohës së garës, apo auto ambulancës mobile që do të qëndroj jashtë sallës deri në përfundimin e garës;
- Të sigurojë karrige për personat zyrtar të FKK-së dhe për mysafir, që do të vendosen prapa tavolinës së komisionit të garave.
- Të sigurojë ndarjen e arenave sportive me distancë të tillë që siguria e shëndeti i garuesve, referëve dhe komisionerëve do të jetë e sigurt dhe do të ruhet gjatë gjithë kohës së garave.
- Temperatura në sallë gjatë garave nuk duhet të jetë më e ulët se 18°C dhe më e lartë se 25°C.

II. Dispozitat përfundimtare

Neni 7.

- *Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për komisionin e garave të FKK -së.*

Neni 8.

- *Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Bordi Drejtues i FKK-së.*
- *Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje kryhen në mënyrë dhe procedurë të njëjtë për të përshkruar miratimin e saj.*

Neni 9.

- Pas miratimit të Bordit Drejtues të FKK-së dhe nënshkrimit të kryetarit, secili akt në këtë rregullore duhet të zbatohet nga ana e komisionit përkatës të FKK-së.

Neni 10.

- Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullorje pushon të vlejë Rregullorja e deritashme.

Prishtinë

19 Qershor 2021

Kryetari i FKK-së

Ismet Krasniqi

FEDERATA E KARATESË SË KOSOVËS

KOSOVA KARATE FEDERATION



**RREGULLORE PËR TRAJNERË DHE ZHVILLIM
PROFESIONAL**

Prishtinë, 2021

RREGULLORE PËR TRAJNERË DHE ZHVILLIM PROFESIONAL

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Fushëveprimi

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të themelojë Komisionin e Trajnerëve dhe Zhvillimit Profesional të FKK-së. Kjo rregullore rregullon mënyrën e përfshirjes dhe formën e veprimit të trajnerëve të karatesë, përfshirë edhe angazhimin e të gjithë ekspertëve të tjerë që punojnë në fushën e sportit të karatesë, që menaxhohet dhe bashkërendohet nga Federata e Karatesë së Kosovës dhe zhvillimit të tyre profesional.
2. Përveç kësaj, Rregullorja gjithashtu përcakton krijimin dhe caktimin e Komisionit të Trajnerëve dhe ekspertëve, si dhe rregullon qëllimin, fushëveprimin dhe procedurat e punës, të drejtat, përgjegjësitë, detyrimet e trajnerëve dhe anëtarëve të komisionit.
3. Qëllimi primar i Komisionit në fjalë është që të ngritë nivelin e punës profesionale të trajnerëve dhe në veçanti arritjes së rezultateve kulmore të kratesë.

Neni 2

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje do të jetë vetëm mbi dhe për trajnerët dhe ndihmës trajnerët që janë anëtarë të klubve të FKK-së.

Neni 3

Ky Komision do të jetë i përbërë nga tre anëtarë. Anëtarët duhet të jenë trajner të klubeve anëtare të FKK-së. Kryesuesi i Komisionit emërohet nga Bordi Ekzekutiv pas aplikimit përmes konkursit të FKK-së. Kryesuesi do të caktojë dy anëtarë tjerë që do të aprovohen nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së. Ky Komisioni i raporton Bordit të FKK-së.

II. KUSHTET E PËRZGJEDHJES SË KRYESUESIT TË KOMISIONIT

Neni 4

Kryesuesi i Komisionit për Trajnerë dhe Zhvillim Profesional duhet të përmbushë kriteret në vijim:

1. Të ketë së paku nivelin më të ultë të mundshëm profesional të arsimit të mesëm.
2. Diploma/Certifikata mbi Përgatitjen e tij/saj profesionale (DAN)
3. S'paku pesë (5) vite përvojë pune të pandërprerë në sportin e karatesë si trener në një klub në FKK,
4. Rezultate të theksuara në punën profesionale dhe pedagogjike me ekipe në sportin e karatesë,
5. Rezultate të theksuara në garat zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare,
6. Preferohet njohja e njëres nga gjuhët zyrtare të WKF-it (angleze, spanjolle dhe frenge).

Neni 5

1. Apliakacioni për kryesues të komisionit duhet të përmbajë:
- Diploma arsimore
 - CV
 - Diplomat/cetifikatat relevante (DAN)
 - Certifikata për trajner vendor/ndërkombtar
 - Dëshmi për punën aktive në 5 vitet e fundit
 - Dëshmi për rezultate e arritura
 - Planin e punës me trajner dhe garues
 - Planin katër vjeçar të punës si kryesues

III. DETYRAT THEMELORE TË KOMISIONIT TË TRAJNERËVE

Neni 6

Detyrat themelore të Komisioni janë si në vijim:

- Përmirësimi i punës së trajnerëve në klube;
- Organizimi i seminareve për trajnerë dhe marrja e licencave të trajnerit;
- Studimi dhe zbatimi i një programi të përbashkët pune të teknikave për provime të nivelit KYU;
- Përmirësimi i punës së trajnerëve përmes llojeve të ndryshme të trajnimeve dhe shkollimit për trajner në institucione të larta sportive, monitorimi i arsimimit të tyre dhe përfshirja e tyre në punën e Federatës;
- Hartimin e propozimeve dhe miratimin e planeve tjera;
- Të hartojë planprogramin për përgaditje për avancim të trajnerëve në nivle të licencave ndërkombëtare (WKF);
- Prioritet në caktim për avancim të trajnerëve për licenca ndërkombëtare duhet të kenë trajnerët e përfaqësueses.
- Kryesuesi i komisionit apo edhe ndonjëri nga trajnerët anëtar i komisionit mund të angazhohet në detyra tjera të cilat nuk bien ndesh me rregulloren e trajnerëve dhe angazhimi i tij/tyre është për të mirë e zhvillimit të trajnerëve dhe karatesë në përgjithësi.

Neni 7

Trajnerët e Federatës së Karatesë së Kosovës ndahen në katër (4) kategori: A, B, C dhe D. Në mungesë të njëres nga këto kategori, asnjë trajner nuk ka të drejtë të qëndrojë prapa garuesit në garat zyrtare të FKK-së.

- Trajner i kategorisë **A** është trajneri i licencuar nga WKF
- Trajner i kategorisë **B** është trajneri i licencuar nga FKK
- Trajner i kategorisë **C** është trajneri i akredituar nga WKF
- Trajner i kategorisë **D** është trajneri i akredituar nga FKK

Neni 8

- Licencimi për kategorinë A nga WKF bëhet kur trajneri i FKK-së i nënshtrohet provimit me shkrim në një nga seminarët për licencim të trajnerëve nga WKF.
- Licencimi për kategorinë B nga FKK bëhet kur trajneri i FKK-së i nënshtrohet provimit me shkrim në një nga seminarët për licencim të trajnerëve nga FKK.

3. Licencimi për kategorinë C nga WKF bëhet kur trajneri i FKK-së i merr pjesë në seminarin për trajnerë të organizuar nga WKF.

4. Licencimi për kategorinë D nga FKK bëhet kur trajneri i FKK-së merr pjesë në seminarin për trajnerë të organizuar nga FKK.

IV. REGJISTRIMI I TRAJNERËVE NË FKK

Neni 9

1. Regjistrimi i klubit në FKK është parakusht për paraqitjen e kërkesës për t'u pajisur me licencë të trajnerit.
2. Pa qenë klubi i regjistruar në FKK, asnjë trajner nuk mund të përfshihet dhe të bashkëpunojë në veprimtaritë dhe/ose programin e FKK-së.

Neni 10

Trajnerët që dëshirojnë të anëtarësohen dhe regjistrohen si trajnerë me të drejta të plota në FKK duhet të përmbushin kushtet si në vijim:

- a) Të jetnë të moshës mbi 21 vjeç;
- b) Të kenë së paku 5 vite përvojë sportive të pandërprere pranë ndonjë klubi të regjistruar në FKK;
- c) Të kenë së paku thirjen 1-DAN
- d) Të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin për aplikim në FKK.

V. AKREDITIMI DHE LICENCIMI I TRAJNERËVE

Neni 11

1. Komisioni për Trajnerë dhe Zhvillim Profesional obligohet të mbajë së paku një herë në vit seminarë për trajner. Seminari është obligativ për të gjithë trajnerët e FKK-së. Pjesëmarrja në seminar është hapi i parë për akreditim dhe licencim të trajnerëve.
2. Kryesusi i komisionit në bashkëpunim me kryesuesin e komisionit të referëve do të zgjedhin formën dhe metodologjinë e organizmit të provimit të licencimit të trajnerëve. Afati i licencave është tri (3) vjet.
3. Trajnerët që ndjekin seminarin dhe i nënshtrohen provimit për trajnerë do të pajisen me akreditim/licencim dhe diplomën e lëshuar nga FKK. Licencat do të lëshohen për trajnerët të cilët e kalojnë me sukses provimin me shkrim, sipas kriterëve të kalueshmërisë së provimit.

Neni 12

Përmbajtja e akreditimit/licencës/diplomës së lëshuar për trajner të FKK-së:

1. Emrin dhe mbiemrin
2. Fotografinë
3. Datën e lindjes
4. Kategorinë e fituar të trajnerit
5. Data e lëshimit dhe skadimit
6. Emblemën dhe Vulën e FKK-së

7. Nënshkrimin e kryetarit të komisionit për trajnerë dhe zhvillim profesional

Neni 13

Tarifa për akreditim dhe licencim të trajnerit do të përcaktohet me vendim të veçantë të Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

Neni 14

Pas skadimit të licencës së trajnerit apo revokimit të të njëjtës, ai/ajo nuk mund të përfaqësoj klubin në gara vendore të organizuara nga FKK.

Neni 15

Akreditimi/licenca mund të tërhiqet në rast të shkeljes së kësaj rregulloreje, keqpërdorimit të akreditimit/licencimit, dëmtimit të imazhit të karatesë dhe shkeljeve tjera. Rastet e tilla do të jenë subjekt të Komisionit Disiplinor.

VI. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E TRAJNERËVE TË FKK-SË

Neni 16

1. Trajneri duhet të veprojë në përputhje me të gjitha detyrimet dhe rregullat e kësaj rregulloreje dhe respektojë të gjitha rregulloret e FKK-së.
2. Të gjithë trajnerët e FKK-së janë të obliguar të respektojnë dhe zbatojnë Kodin e Etikës së FKK-së.

Neni 17

Detyrat e trajnerëve janë:

1. trajnimi dhe masovizimi i sportit të karatesë;
2. ata me punën e tyre duhet të kontribuojnë në edukimin e karatesitëve në frymën e karatesë, sportit, ferpllejt dhe barazisë;
3. kryen punën sportive në përputhje me kërkesat e profesionit të tij dhe normat morale që dalin nga etika profesionale e thirrjes së tij;
4. monitoron dhe studion vazhdimisht arritjet e karatesitëve me të cilët punon;
5. lufton kundër fenomeneve negative në sport, përdorimin e farmakologjikëve të paligjshëm, narkotikëve dhe substancave të dëmshme për atletët;
6. kontribuon në reputacionin e profesionit të tij përmes punës, sjelljes dhe qëndrimit të tij ndaj njerëzve;
7. trajnerët duhet të kenë njohuri me parimet e anti-dopingut

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PINRFUNDIMTARE

Neni 18

Interpretimi i kësaj Rregulloreje bëhet nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.

Hyrja në fuqi

Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit të Bordit Ekzekutiv dhe nënshkrimit nga Kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 Qershor 2021

Ismet Krasniqi



Kryetar